



KOLEGJI UBT

FAKULTETI I INXHINIERIS SE NDËRTIMIT (NDËRTIMTARI DHE INFRASTRUKTURE)

Date : 09.06.2017

D.Nr: 18.24.07

VIZITA STUDIMORE NË AUTOSTRADËN „ARBËR XHAFERI” (SEGMENTIN E SOJEVË-PJESA VERIORE E KAÇANIKUT)- REALIZUS I PUNIMEVE “Bechtel Enka”



INFORMATE

Të përgjithshme

Emri i institucionit:	Kolegji për Biznes dhe Teknologji
Fakulteti:	Fakulteti i Inxhinierisë ndërtimore
Programi i studimeve:	Bachelor
Viti i studimeve:	III^{te}
Lëndët:	Multidisiplinare
Vendi i nisjes:	UBT – Prishtinë
Ora e nisjes:	9:00
Numri i studentëve:	22
Data:	09. Qershor. 2017

Hyrje

Në kuadër të bashkëpunimit që ka Kolegji për Biznes dhe Teknologji (UBT) dhe “Bechtel Enka” (realizues i punimeve në autostradën „Arbër Xhaferi”), studentet e vitit të III të Fakulteti të Inxhinierisë Nëndrtimore me datë 09. Qershor.2017 realizuan një vizitë studimore një ditore në segmentin (kilometri 16 deri në kilometrin e 18) nga vendbanimi Sojevë deri në anën veriore të Kaçanikut.

Qëllimi: Vizita studimore kishte për qëllim:

- Së pari që studentet të njihen me rolin, rëndësinë dhe veprimet e aktivitetet të cilat zhvillon gjatë ndërtimit të veprave inxhinierike, konkretisht në Autostradën „Arbër Xhaferi”.
- Së dyti që studentet të njihen nga afër me pjesen më të madhe të veprave (objekteve) inxhinierike të cilat janë në ndërtim e sipër në Autostradën „Arbër Xhaferi”.

Realizimi i vizitës studimore/Agjenda/

Vizita studimore u realizua sipas kësaj agjende:

- Nijsa me grupin e studentëve u bë nga objekti i UBT-së në Prishtinë në ora 09:00.
- Grupi i studentve ishte gjithsej 22 student.
- Arritja në Kampin e Kompanisë “Bechtel Enka” u bë në ore 09:50

Në kampin “Bechtel Enka” në Sojevë ne u pritëm nga: z. Latif Renda, menaxher i departamentit për komunikim me publikun, znj. Arta Salihu, zyrtare për marrdhënie me publikun dhe znj. Andrea, koordinatore për marrdhënie me publikun. Në prezantim e sipër z. Latifi shprehi një falenderim për ne dhe në përgjithësi për UBT-në e cila në vijimësi është duke mbajtur kontakt bashkëpunim me Kompaninë “Bechtel Enka”. Pas një njoftimi të shkurtë në lidhje me rregullat, lëvizjen dhe sjelljet e përgjithshme që duhet bërë gjatë gjithë kohës së qëndrimit në zonën e kantjerit të ndërtimit, ai tregoi se kohëzgjatja e kësaj vizite do të jetë nga ora 10:00 deri në ora 15:00, dhe me këtë rast tregoi se do të vizitohet segmenti Sojevë-pjesa veriore e Kaçanikut (segmenti 16 dhe 18). Po ashtu z. Latif, për të gjithë që nuk kishin pajisje personale për mbrojtje dhe siguri në punë ofroi helmata, syze dhe jelek duke kompletuar grupin me pajisjet minimale për mbrojtje dhe siguri në punë.

Pas këtij momenti ai ftoi që të vije prof. Nebih Pllana dhe prof. Reçica të cilët na shoqëruan gjatë gjithë kohës së bashku me përfaqësuesen e “Bechtel Enka” -së znj. Arta Salihu.

Me këtë rast studentet patën rast të njihen dhe të shohin nga afër pjesen më të madhe dhe më të rëndësishme të punimeve ndërtimore të cilat janë duke u realizur në këtë segment të autostradës. Ndonëse e shkurtë në kohë, kjo vizitë studimore ishte një praktikë ideale për faktin se krijoi mundësi që studentet ta integrojnë pjesen teorike të dëgjuar në leksione me ato praktike se si realizohen punimet në terren. Studentet panë element të cilat lidhen me disa nga lëndet të cilat tani më veç i kanë dëgjuar (mësuar) nga aspekti teorik si psh: Mbrojtja në Punë, Punimet Tokësore, Gjeomekanike, Nateriale Nëndrtimore, Konstruksioni, Betoni etj. Nga këndvështrimi i mbrojtjes dhe



sigurisë së shëndetit në punë u arrit që studentet të shohin pajisjet personale për mbrojtje në punë, shenjat për siguri dhe mbrojtje në punë (sinjalizimin horizontal dhe vertikal), rrugët e lëvizjes në kantjer ndërtimi, automejtet për ndihmen e parë, pastaj masat për zvogëlimin e pluhurit e cila realizohej përmes ujitjes me autobote (tanke uji) etj. Sa i takon punimeve tokësore aty u panë të gjitha komponentet dhe elementet që lidhen me punimet tokësore siç psh: inçizimi gjeodezikë, pastrimi i terrenit, gërmimin, prerjet, mbushjet, rrafshimin, ngjeshjen, kanalet e kullimit dhe drenimit të ujërave, formimin e skarpateve nga të dy krahet e autostradës, masat për rritjen e shkallës së sigurisë për skarpatat e pjerrta të cilat konsideroheshin me tendenca të lëvizjes së masave të dheut (shkëmbit), përgatitjen e shpimeve për vendosjen e ankerave, vendosjen e ankerave, veshjen e shpateve (skarpateve) me rrjeta metalike dhe solucion betoni me trashësi mbi 10 cm, hapjen dhe vendosjen e gypave për drenazhimin e ujërave nga shpati. Përdorimin e gjeotekstileve në pozicione të ndryshme të vendosjes dhe realizimit të veprave inxhinierike, hapjen dhe ndërtimin e kanaleve për drenimin e ujërave, ndërtimin e basenve sedimentuese për ujërat atmosferike dhe ujërave që vijen nga reshjet atmosferike etj.



Foto.1. Pamje nga vizita studimore

Sa i takon aspektet e gjeomekanike, studentet panë nga afër lloje dhe tipe të ndryshme të dherave qoftë si bazament në të cilën ndodhet shtrati i autostradës, qoftë të zbuluara me punimet tokësore të sondimit, gërmimit dhe prerjeve, pastaj përdorimin e materialeve të fraksioneve nga më të ndryshme që lidheshin me granulometrinë, porozitetin, peshën vëllimore, specifike, lagështinë, konsolidimin e trolit etj. Në pikëpamje të përdorimit të materialit ndërtimor ata panë se gjatë ekzekutimit të punimeve ishin duke u përdorur materiale dhe receptura të ndryshme nga materiale rrethore dhe të marrë nga distanca e afërt. Vërehej një përdorim i theksuar i materialit nga shkëmbinj sedimentar dhe metamorfik dhe pjesërisht magmatikë. Përdorim i betonit, hekurit, gjeotekstilin etj. Elementet konstruktive që arriten ti shohin studentet ishin ato në pozicionet e urave, kalesave, kanaleve, pusetave, vend shtangimit të pozicionit të sinjalizimit, pilotave, përgatitjes së parafabrikateve të trajteve etj. Nga aspekti i strukturave studentet arriten të shohin punime nga sturkura betoni me dimenzione nga më të ndryshmet të cilat ishin aplikuar në të gjitha objektet inxhinierike brenda këtij segmenti të autostradës „Arbër Xhaferi”.

Gjatë kësaj vizite studimore për student u realizuan dy teste;

- Testi i parë kishte të bënte me matjen e koeficientit të ngjeshjes së shtresave të asfaltit përmes aparatit të TROXLER (metoda joshkatruese) e cila sipas shpjegimit të dhënë aty kishte një rezultat matje deri në 95% të saktë.
- Testi i dytë kishte të bënte me matjen e uljes së pilotës për forca goditëse duke filluar nga 50 cm e tutje, e cila realizohej me pajisje konstruktive të konstruktuar mbi pilot duke e vë në funksion përmes vinçit ngritës me masë goditëse 15 ton. Metoda e përdorur ishte metoda dinamike qëllimi i saj përcaktimi i aftësisë mbajtëse të pilotës.

Studentet gjatë gjithë kohës ishin aktiv duke bërë pyetje në lidhje me: materialet e përdorura, llojet e dherave, granulometrin, numrin e shtresave të rrugës, temperaturën e asfalt, mëyra e përgatitjes së konstruksioeve të parafabrikateve, trajte etj.

Gjatë gjithë kohës së qëndrimit në kantjerin e ndërtimit të këtij segmenti të autostradës „Arbër Xhaferi”, prof. Pllana bëri shjegime dhe sqarime profesionale në detale për secilen vepër inxhinierike duke filluar nga punimet më të thjeshta inxhinierike (punime tokësore) e deri te ato komplekse siç ishin urat, strukturat e betonit, përgatitja e parafabrikateve, bartja dhe montimi, pilotimi testet për pilotim dhe asfalt etj. Po ashtu prof. Pllana bëri sqarime dhe përgjigje të gjitha pyetjeve të shtruar nga studentet duke i trajtuar ato në shkallë të lartë të profesionalizmit teorik dhe praktik.





Foto.2. Pamje nga vizita studimore

Pas kthimit në Kampin e “Bechtel Enka” -as në Sojevë, studentet e UBT, para znj. Anderea, koordinatore e departametit për mardhënie me publikun i shprehen ndjenjen e tyre në lidhje me mënyren e organizimit, pritjen, shpjegimet, si dhe njohurit e fituara me këtë rast. Të gjithë një zëri ishin të mendimit se kjo vizitë studimore ishte një nga rastet e veçanta, i cili to të kontribuoj në zhillimin dhe hapje e horizontit të dijes për ta.

Rezultatet

1. Është arritur të realizohet pjesa e planifikuar e programit të punës;
2. Është arritur që studentet të krijojnë një vizion të qartë në lidhje me realizimin e veprave inxhinierike (rasti konkret në një rrugë të rendit Autoudhë -strat);
3. Është arritur që studentët ta integrojnë pjesen teorike me ate paraktike për sa i takon realizimit të veprave (objekteve) inxhinierike në përgjithësi;
4. Është arritur që studentet edhe një herë nga afërt të forcojnë dijen në lidhje sigurin dhe mbrojtjen në punë;
5. Konsiderohet se studentet me përvojën e fituar mund dhe janë të aftë të zgjidhin probleme inxhinierike për lloje të ndryshme të veprave inxhinierike;

Përfundime

Konsideroj se vizita studimore në *kantjerin e ndërtimit të Autostradës „Arbër Xhaferi”* jo vetëm që ka përmbushur detyrimin sipas syllabusit të disa lëndëve, por gjithashtu mendojmë se studentet këtë përvojë mund ta integrojnë në mënyrë të fortë me bazën teorike.

Falenderimi:

Me këtë rast duam të shprehim falenderime më të sinqerta për z. Latif Renda, znj. Arta Salihu, znj. Andera, dhe në përgjithësi për Kompaninë “Bechtel Enka” për bashkëpunim dhe ofrimin e kësaj mundësie për studentet dhe stafin akademik të UBT që të realizojmë këtë vizitë studimore.

Një falenderim i veçantë shkon për prof. Nebih Pllana, pa të cilin realizimi i kësaj vizite studimore do të ishte vështirë të arrihej, gjithashtu falenderojmë edhe prof. Reçica i cili gjithë kohës na lehtësoj me sqarime dhe këshillime profesionale.

Pjesëmarrja:



Pjesëmarrja e studentëve në vizitën studimore ishte e knaqëshme, ndonëse me një pritje më të madhe.

Mbarimi i vizitës

Vizita studimore mbaroj në ora 14:50, në ora 15:00, ne u larguam nga Kampi i “Bechtel Enka” -së në Sojevë dhe vazhduam rrugën për në Prishtinë.

Koha e kthimit në UBT

Në ora 16:15 ne arritem para objekti të UBT-së në Prishtinë dhe me kaq e mbyllem një vizitë studimore një ditore në segmentin e Autostradës „Arbër Xhaferi”.





Pristine
2017

